



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR SHËNDETËSINË DHE MBROJTJEN SOCIALE
DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 1069 Prot.

Tiranë, më 23/02/2024

URDHËR

Nr. 98, Datë 23/02/2024

**“PËR PËRCAKTIMIN E FORMATIT TË LICENCËS PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME PRODHIMIN E CANNABIS PËR QËLLIME
MJEKËSORE”**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar dhe të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”,

URDHËROJ:

1. Licenca, për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore është sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij Urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR

Albana KOÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

L I C E N C Ë

NR. _____, DATË _____

“PËR

USHTRIMIN E AKTIVITETEVE TË LIDHURA ME PRODHIMIN E CANNABIS PËR QËLLIME MJEKËSORE”

Në mbështetje të ligjit nr. 61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale” dhe Vendimit të Komisionit të Licencave Nr. _____, datë _____,

I JEPET

SUBJEKTIT: _____,

ADRESA: _____,

AFATI: _____,

ZONA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT: _____,

PËR VEPRIMTARITË E MËPOSHTME:

- kultivimin, prodhimin e bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore
- transportimin e farërave, bimëve dhe produkteve e nënprodukteve të cannabis-it për qëllime mjekësore në territorin e Republikës së Shqipërisë
- eksportin e bimëve, produkteve dhe nënprodukteve të cannabis-it për qëllime mjekësore

KUSHTET E LICENCËS:

Kjo licencë lëshohet në përputhje me ligjin nr. 61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së cannabis-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Subjekti në ushtrimin e aktivitetit të tij, vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

MINISTËR

(Emër, Mbiemër)

(Firmë)